

## RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Master Profesional “Interier Dizajn”

Ofruar nga Albanian University

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

1.Dr. Sonia Jojiç

2.Dr. Artan Hysa



(Qershor 2019)

## RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

### Për Programin e studimit Master Profesional "Interier Dizajn"

Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit:		
1	IAL Aplikues:	Albanian University
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike
3	Urdhëri/VKM i licencimit	UMASH Nr 669, datë 12.10.2018
4	Titulli i programit të studimit:	Master profesional në "Interier Dizajn"
5	Cikli i studimit:	Cikli I dytë
6	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik
7	Kreditet në total (ECTS):	60 kredite
8	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
9	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
10	Programi ofrohet vetëm nga institucioni	Po
11	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Jo
12	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
13	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
14	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 7 (shtatë)
15	Aktivizimi i programit të studimit	2018-2019
16	Numri i studentëve	8 studentë
	etj	

Shenim: Tabela plotësohet nga Specialisti i ASCAL

## HYRJE

### Të dhëna për programin e studimit MP në “Interier Dizajn”

Programi i studimit Master Profesional në “Interier Dizajn” pjesë e Departamentit të Arkitekturës në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara të Albanian University është një program i ciklit të dytë të studimit Master Profesional i hapur në vitin akademik 2018-2019.

Programi i ciklit të dytë të studimit, Master Profesional në “Interier Dizajn”, është hapur me Urdhër Nr.699, datë 12.10.2018 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Ky program ofrohet në gjuhën shqipe, me kohëzgjatje 1 Vit akademik, 2 semestra, 60 kredite, i cili realizohet me kohë të plotë. Në përfundim të studimeve të këtij programi lëshohet diplomë *Master Profesional* në “Interier Dizajn”.

### GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

Dr. Sonia Jojiç

Dr. Artan Hysa

Menaxhere teknike e ndjekjes së këtij programi studimi, është Specialistja e Sektorit të SPVC, Zj. Suela Kromidha. Më datë 15.05.2019, nëpërmjet sistemit AMS është dërguar në Institucion Draft RVJ. Më datë 21.05.2019 vjen përgjigja nga Institucioni në lidhje me këtë Draft. GVJ e pa me kujdes përgjigjen e AU dhe merr në konsideratë disa prej pikave duke bërë ndryshimet përkatëse në raportin përfundimtar. Disa prej komenteve të AU, GVJ nuk i merr në konsideratë duke dhënë edhe sqarimin përkatës. Komentet e Draft RVJ, përgjigjen e AU dhe përgjigjen e GVJ për çdo pikë të kontestuar të Draft RVJ, e gjeni në fund të RVJ.

#### 1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

##### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Grupi i Vleresimit të Jashtëm (GVJ), mbështetur në dokumentacionin e paraqitur në Dosjen e vetvlerësimit nga Albanian University për këtë program studimi dhe konkretisht në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm dhe në Rregulloren e këtij programi, shprehet se:

Programi i studimit Master Profesional “Interier Dizajn” fokusohet në fushën e dizajnit të interierit, profil po aq i ri për Shqipërinë, duke parë dinamikat e zhvillimit të këtij programi në një kontekst të mungesës së kapaciteteve profesionale për adresimin e tyre.

Programi i studimit Master Profesional “Interier Dizajn” përmban objektiva të përgjithshëm për formimin e studentëve, si dhe objektiva specifike për profil, si më poshtë:

- Krijimin e specialistit në “Interier Dizajn” nëpërmjet përgatitjes teorike praktike gjatë periudhës 1-vjecare, duke mundësuar një afrim të menjëhershëm në tregun e punës si dizajnues të hapësirave të brendshme.

Objektivat specifike të këtij programi fokusohen në:

- Njohjen e materialeve dekorative dhe ndërtimore, karakteristikat fiziko-mekanike dhe proceset teknologjike të prodhimit dhe trajtimit të tyre në estetikën e interierit.
- Vlerësimit dhe seleksionimit të burimeve të dritës duke qenë në gjendje të llogarisë ndriçimin e ambienteve të mbyllura sipas kërkesës dhe normave të CE

- Të njohë problematikat e interierit dhe të jetë në gjendje të japë zgjidhje praktike, funksionale dhe estetike të interiereve, nëpërmjet aredimit, përdorimit të ngjyrave, dritës materialeve, etj.
- Të ketë aftësi analizuese dhe krijuese mbi interieret me funksione të ndryshme.
- Të ketë aftësi prezantuese të projektit e mënyre që të shprehi sa më mirë veten.

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Bazuar në raportin e vlerësimit të brendshëm, anekset që i bashkëngjiten këtij raporti, vizitës në institucion dhe kontrollit të dokumentacionit, rezulton se Programi i studimit, Master Profesional në “Interier Dizajn” është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit. Veprimtaritë formuese, sipas të cilave është organizuar programi i studimit, kanë objektivin e krijimit të ekspertëve të kualifikuar në fushën e specifikuar.</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në “Interier Design”, siç e thamë edhe më lart, është hartuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit, kjo e vërtetuar më së miri në përvojën disavjeçare të institucionit në të kontribuarit për përgatitjen profesionale të arkitektëve të rinj në vendin tonë. Përputhja me misionin dhe qëllimin e institucionit paraqitet në evidencën 1.3, neni 36, faqa 32.</p> <p>Hartimi i programit të studimit Master Profesional në “Interier Design” është bazuar në studimin mbi tregun e punës paraqitur në evidencën 1.4. Ky studim është përgatitur në mënyrë të suksesëshme duke patur parasysh kohën e shkurtër pas miratimit të formimit të grupit të punës. Gjithsesi, ky studim mund të përmirësohet duke zgjeruar numrin e subjekteve të pyetura, specifikimin e numrit të punonjësve teknik (përfshirë administrativ), përfshirja e të diplomuarve si pjesë e arkitektëve të rinj në treg, përfshirja e përdoruesve kryesorë të hapësirave të brendëshme dominante si banesa apo bar-kafe.</p> <p>Zhvillimi ekonomik i vendit konkretizuar me një shtim të vazhdueshëm të ambjenteve të banimit dhe të bar-kafe, rrjedhon në një nevojë për profesionistë të fushës së interior design për projektimin e këtyre ambjenteve. Ky fakt është raportuar në studimin e tregut (evidencë 1,4).</p>
<b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kjo qartësohet nga informacionet e marra në IAL dhe gjatë diskutimeve, konsultimit me dokumentacionin përkatës.</p> <p>Hartimi i këtij programi është mbështetur në formimin e profesionit të ekspertit në Interier Dizajn.</p>

	Programi i studimit Master Profesional në “Interior Design” është në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit (Evidenca 1.5, faqe 5-6) dhe specifikisht të Departamentit të Arkitekturës (Evidenca 1.2, faqe 2-3)
<b>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Programi zbaton Ligjin 80/2015 i cili parashikon përshatje të programeve Master Profesional në programe me 60 ose 120 ECTS, dhe kohëzgjatje 1 vit me kohë të plotë në gjuhën Shqipe. Ky program ofrohet me 60 kredite, 2 semestra. Kjo konstatohet nëpërmjet konsultimit me dokumentacionin përkatës.</p> <p>Kurrikulat dhe syllabuset janë në përputhje me VKM Nr.41 që daton 24.01.2018.</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në “Interior Design” përmban elementët e mjaftueshëm akademikë për tu kualifikuar si program i ciklit të dytë. Referuar kornizës Shqipëtare të Kualifikimeve ai përkon me nivelin e 7-të të kualifikimit.</p>
<b>Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	Referuar Planit Strategjik të Zhvillimit Institucional (Evidenca 1.5) si dhe Planit Strategjik të zhvillimit të Departamentit të Arkitekturës për vitin akademik 2018-2019, institucioni percakton hapa konkret për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve (Evidenca 1.5, faqe 11, 18 & Evidenca 1.2, faqe 2-3).
<b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b>	
<p>Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni dhe takimet gjatë vizitës në institucion:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. GVJ gjykon se programi është hartuar në përputhje me misionin e institucionit dhe strategjinë e tij të zhvillimit (aktualisht në fuqi strategjia 2014-2020).</li> <li>2. Programi i studimit merr në konsideratë nevojat e tregut të punës, zhvillimin ekonomik të vendit dhe vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</li> <li>3. Programi është i organizuar konform kuadrit ligjor në fuqi.</li> <li>4. Mbështetja në përvojën disavjeçare të vendeve të Europës perëndimore si SHBA, Kanda dhe Angli është për tu vlerësuar. Sugjerohet referimi dhe i shembujve të suksesshëm të programeve Master Profesional 1 vjeçar nga vende të ngjashme rajonale; Greqi, Turqi, Serbi, dhe Kroaci.</li> </ol>	

## 2. Struktura akademike e Fakultetit (Departamentit përgjegjës për programin e studimit)

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Nga takimi me drejtuesit e Fakultetit dhe me të Departamentit, u konstatua se pas hyrjes në fuqi të ligjit 80/15 dhe miratimit nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë, të Statutit në fuqi të Albanian University, tashmë njësia përgjegjëse për organizimin e programit është Departmenti i Arkitekturës. Ky Departament është pjesë përbërëse e Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike. (Më herët të gjithë programet organizoheshin në nivel Fakulteti). Departamenti i Arkitekturës është një nga 3 njësitë bazë të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, i cili përbëhet nga staf akademik efektiv dhe me kontratë.

## Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura akademike e Fakultetit

Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike në Albanian University është i përbërë nga 3 njësi bazë; Departamenti i Arkitekturës; Departamenti i Shkencave Ekonomike; Departamenti i Inxhinierisë. Të dhëna më të detajuara, për përbërjen e stafit për vitin akademik 2018-2019, në këto Departamente e gjeni në Anekse, tabela 1

Personeli akademik për çdo njësi bazë: PAE, PAK, PA, titujt/gradat, (Shiko Anekse, tabela Nr 2)

Departamenti i Arkitekturës është i përbërë nga 10 (dhjetë) anëtarë si staf akademik efektiv (PAE) dhe 8 (tetë) anëtarë si staf akademik me kontratë (PAK) dhe 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë të personelit administrativë (PA), kurse sa i përket kualifikimit nga 10 Personel Akademik Efektiv, 6 staf kanë Tituj/Grada (1 Prof As; 5 Dr; 4 Msc); dhe nga 8 staf Personel Akademik me Kontratë, 6 janë staf me Tituj/Grada (1 Prof. Dr; 5 Dr; 2 Msc).

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor".</p>	<p>Mbështetur në dokumentacionin e RVB si dhe dokumentacioneve përkatëse të vëzhguara gjatë vizitës në IAL, Albania University në përbërjen e tij ka 3 Fakultete të cilat plotësojnë numrin e njërive kryesore që duhet të përfshijë një IAL me statusin Universitet. Përkatësisht emërtimet e tyre janë si më poshtë vijon:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike<ul style="list-style-type: none"><li>Departamenti i Shkencave Ekonomike</li><li>Departamenti Arkitekturës</li><li>Departamenti Inxhinierive</li></ul></li><li>Fakulteti i Shkencave Shoqërore<ul style="list-style-type: none"><li>Departamenti i Shkencave Juridike</li><li>Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative</li><li>Departamenti i Psikologjisë së Përgjithëshme</li><li>Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes</li></ul></li><li>Fakulteti i Shkencave Mjekësore<ul style="list-style-type: none"><li>Departamenti i Stomatologjisë</li><li>Departamenti i Farmacisë</li><li>Departamenti i Infermierisë dhe Fizeoterapisë</li></ul></li></ol> <p>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike është i organizuar në tre Departamente. Ashtu siç paraqitet dhe në organigramën e dhënë nga Albania University, paraqitet dhe zyra e kordinimit të kërkimit shkencor dhe botimeve akademike.</p> <p>Institucioni funksionon bazuar në një organigramë funksionale, që mirëpërcakton marrëdhënien institucionale që çdo njësi e tij ka me njëra-tjetrën.</p> <p>Departamenti i Arkitekturës ka në përbërjen e tij 10 anëtarë efektivë si personel akademik. Ndër të cilët 1 mban gradën Prof.Asoc.Dr dhe 5 të tjerë mbajnë gradën Dr.</p>
<b>Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p>	<p>Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike është përgjegjës për hartimin e programit Master Profesional "Interior Dizajn".</p>

<p><b>Kriteri 2</b> Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Kriteret e rekrutimit të stafit akademik janë të përcaktuara në rregulloren institucionale të IAL mbështetur edhe në kontratat e përcaktuara nga Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë.</p> <p>Rekrutimi i stafit fillon me shpalljen e vendit vakant nga departamenti, i cili përcakton dhe kriteret që kandidatët duhet të plotësojnë.</p> <p>Përgjegjësitë e Fakultetit si dhe të departamentit të Arkitekturës si njësi bazë janë të mirëpërcaktuara në Rregulloren e Funksionimit të Fakultetit dhe Departamentit si dhe në Statut. Njësia bazë e Departamentit të Arkitekturës rezultojnë të ndërgjegjshme në raport me këto përgjegjësi duke qënë aktiv dhe transparent në shumë vendimarrje.</p> <p>Departamenti i Arkitekturës rezultojnë të përfshihet zyrtarisht në proceset e rekrutimit të stafit akademik. Fillimisht duke raportuar nevojat për semestrat, në vazhdim nëpërmjet kërkesave drejtuar Fakultetit, si dhe duke qënë njësi kryesore në proceset e përzgjedhjes së kandidatëve për vende vakante.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Institucioni Albanian University është organizuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe në mënyrë të tillë që të përmbushë misionin e tij.</li> <li>2. Institucioni, Njësia Kryesore dhe Njësia bazë përgjegjëse për këtë program, plotësojnë standardet dhe treguesit sasiorë sipas kriterëve të përcaktuara e të paraqitura respektivisht.</li> <li>3. Bazuar në evidencat bashkëngjitur RVB-së institucioni vepron në përputhje me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar si në nivel institucional ashtu edhe në nivel njësie bazë.</li> <li>4. Institucioni përmbush kriteret sasiorë duke patur 3 fakultete me të paktën tre njësi baze secila, si dhe duke plotësuar kushtet e nevojshme të stafit akademik në sasi dhe grada shkencore.</li> <li>5. Përgjegjshmëria e njësive bazë për përgjegjësinë e tyre për realizimin e programeve të studimit është evidente në një sërë evidencash në lidhje me kontrollimin e ecurisë së mësimdhënies, konsiderimin e vlerësimit nga ana e studentëve, vlerësimin semestral të ecurisë së lëndëve, nxitja dhe monitorimi i aktiviteteve shkencore, etj.</li> <li>6. Departamenti i Arkitekturës është njësi bazë e cila inicion dhe është aktive në procesin e vlerësimit të kandidat pedagogëve për vende vakante të stafit akademik.</li> <li>7. Rekrutimi i personelit akademik dhe vlerësimi i tij bëhet sipas dispozitave ligjore e akteve nënligjore me pjesëmarrjen e departamentit dhe fakultetit. GVJ konsultoi dokumentacionin e krijuar për rekrutimin e personelit nëpërmjet zgjedhjes rastësore dhe evidentoi korrektësinë në arkivimin e tyre.</li> </ol>	

### 3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Aktualisht, personeli akademik në programin e studimit Master Profesional në "Interier Dizajn", është i përbërë nga 6 staf akademik me kohë të plotë dhe 3 staf me kohë të pjesshme, për një raport PAE/PAK 67% me 33% përsa i përket pikëpamjes numerike. Në Departamentin e Arkitekturës në të cilin zhvillohet edhe programi Master



Profesional "Interior Dizajn", ngarkesa e personelit akademik është në përputhje të plotë me parashikimet nënligjore për aktivitetet dhe standardet mësimore të personelit akademik në IAL, në varësi nga niveli i kualifikimit.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Shiko Anekse, Tabela 4)

Personeli akademik në programin e studimit Master Profesional në "Interior Dizajn" në Fakultetin e Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike është 6 Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe 3 Personel Akademik me Kontratë (PAK). Në këtë program studimi 2 Personel Akademik Efektiv (PAE) mbajnë Titullin "Prof. Asoc. Dr."; 3 gradën shkencore "Doktor", dhe 1 titullin "Master Shkencor". Nga Personeli Akademik me Kontratë (PAK) 1 mban titullin "Prof.Dr"; 1 gradën shkencore "Doktor Shkencash" dhe 1 Doktor në Proces.

Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinator/ët e programit të studimit

Nuk është paraqitur apo evidentuar Këshill Shkencor për këtë program studimi. Ndërkohë Koordinatore e këtij programi është Msc E. K, personel akademik i brendshëm i AU.

Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Shiko Anekse, Tabela 5)

Kualifikimi i personelit akademik dhe drejtuesit akademikë në këtë program studimi është i raportit 0/1 Prof. (PAE /PAK); 2/0 Prof. Asoc. (PAE/PAK); 3/1 Dr. (PAE / PAK) dhe 0/1 Asistent lektor në proces Dr. (PAE/PAK); 1/0 Asistent lektor me MSc. (PAE/PAK); 1/0 Personel Ndhmës (PAE / PAK); 7/0 Personeli ndihmës-akademik me karakter administrativ (PAE / PAK).

Të dhënat sipas seksit. Të dhëna sipas moshës së personelit (Shiko anekse, Tabela 6)

Nga tabela 6 në aneks, vihet re që në shpërndarjen e moshës së stafit të angazhuar në programin e studimit Master Profesional "Interior Dizajn", drejtuesit e lëndëve janë kryesisht në grupmoshat 46-68 vjeç, stafi i ri i grupmoshës 25-35 vjeç janë të angazhuar si personeli ndihmës-akademik me karakter administrativ.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Gjatë vizitës në Albanian University, GVJ u informua se për sa i përket procedurës së lidhjes së kontratës së punës, për çdo anëtar i stafit administrativ dhe stafit akademik efektiv apo me kohë të pjesshme ndiqet një procedurë e cila nis me procesin e rekrutimit dhe përzgjedhjes, informimit të personit për përzgjedhjen e tij për t'u marrë në punë pranë Albanian University dhe më pas ai paraqitet dhe nënshkruan kontratën e punës e cila legalizon pozicionin e tij. Kontrata përfshin njohjen me detyrat dhe të drejtat e të dy palëve.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Stafi ndihmës administrativë në njësi bazë në përgjithësi rezultojnë me eksperiencë të konsiderueshme në pozicionet përkatëse.

#### **Vlerësimi sipas Standardeve**

<b>Standardi/Kriteret</b>	<b>Vlerësimi sipas standardeve</b>
<b>Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;	Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në mënyrë të vazhdueshme në aktivitet të ndryshme në përputhje me objektivat e programit MP në Interior Dizajn si



<p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>dhe në akordancë me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>
<p><b>Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve; <b>Kriteri 2</b> Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Personeli akademik i Departamentit të Arkitekturës ka luajtur rol kryesor në përpilimin e kurrikulës së programit MP në Interier Dizajn. Për më tepër ata janë anëtar aktiv të grupeve të punës për rishikimin e kurrikulave dhe përmirësimin e syllabuseve.</p> <p>Si procedurat e rekrutimit ashtu edhe ngarkesa mësimore e cilit pedagog është në përputhje me legjislacionin përkatës.</p>
<p><b>Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren; <b>Kriteri 2</b> Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve; <b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit; <b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Departamenti i Arkitektures si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit MP në Interier Dizajn, ndjek procedurat ligjore dhe të bazuara në rregulloret e brendshme në rekrutimin e stafit. Në periudhën e përgatitjes për semestrin e ri, Departamenti i Arkitekturës paraqet kërkesë zyrtare dekanatit mbi nevojën për personel.</p> <p>Raporti i PAE/PAK në aspektin numerik është 6/3 duke shënuar 67%. Ndërkohë, si ngarkesë mësimore, PAE mbulojnë 76% të mësimdhënies për vit akademik, fakt i cili konsiderohet si plotësim i kriterit 2.</p> <p>Institucioni në nivel qëndror ashtu edhe nivel njësie bazë realizon procese vlerësimi komform legjislacionit në fuqi si dhe në metoda transparente. Formularët e vetëvlerësimit ashtu edhe pyetsori për studentët janë shembuj në këtë kontekst.</p> <p>Dokumentacioni si bazë e të dhënave të raporteve të rekrutimit të personelit është evidentuar gjatë vizitës në institucion që arkivohet me korrektësi në zyrën e burimeve njerëzore. Ndërsa njoftimet për vende vakante arkivohen në nivel njësie baze.</p>
<p><b>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete; <b>Kriteri 2</b> Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”; <b>Kriteri 3</b> Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi; <b>Kriteri 4</b> Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p>	<p>Përgjegjësi i programit të studimit MP në Interier Dizajn mban titullin “Profesor i asociuar”</p> <p>Titullarët e cdo lënde në programin e studimit MP në Interier Dizajn mbajnë gradën “Doktor”.</p> <p>Dekani, përgjegjësi i departamentit të Arkitekturës si dhe përgjegjësi i programit të studimit MP në Interier Dizajn, janë të punësuar me kohë të plotë.</p> <p>Institucioni ka mundur të personeli të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikqyrien e praktikave mësimore të programit të studimit MP në Interier Dizajn. Këto praktika janë lehtësuar me anë të marrëveshjeve dy palëshe të bashkëpunimit që departamenti i arkitekturës ka bërë me subjekte</p>

<p><b>Kriteri 5</b> Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>private aktive në fushën e arkitekturës, interior design, dhe materialet e ndërtimit.</p>
<p><b>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;  <b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore "Doktor";  <b>Kriteri 3</b> Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Çdo student aktiv në programin e studimit MP në Interior Dizajn ka një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli.  Të dy udhëheqësit aktual kanë gradë shkencore "Doktor i shkencave"  Udhëheqësit aktual kanë një shpërndarje 5 me 3 studentë duke qënë brenda limiteve ligjore.</p>
<p><b>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.  <b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Fushat kërkimore të udhëheqësve janë në përputhje me fushën studimore të programit të studimit MP në Interior Dizajn.  Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Albanian University mbi orët e kryerjes së tezës së diplomës, si dhe nga intervistat e kryera gjatë vizitës, rezulton se Punimi i diplomës zhvillohet vetëm nëpërmjet konsultimeve me pedagogët e zgjedhur, 1 pedagogë PAE- 5 student; dhe 1 pedagogë PAK - 3 student, ndërkohë që punimi i diplomës është i përbërë nga 12 kredite gjatë semestrit të dytë  Orari mesimor, dokumenton me se miri dhe realizimin e oreve mesimore për cdo lende, duke përfshirë dhe atë të Punim Diplomes e cila perbehet nga 12 ECTS, 24 ore në semester Detyra / Projekt, dhe 1.6 ore në auditor në javë me një numer total prej 18.4 oresh total jashte auditorit.</p>
<p><b>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;  <b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Institucioni, si në nivel Universiteti ashtu edhe në nivel njësie baze, Departamenti i Arkitekturës dhe Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, aktivizon optimalisht personelin ndihmës mësimor-shkencor në përmbushjen e objektivave të orëve laboratorike si dhe mirembajtjen e tyre. Gjithashtu, ai mundëson edhe angazhimin e personelit administrativ në mbështetje të arritjeve e objektivave të programit të studimit MP në Interior Dizajn.</p>
<p><b>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;  <b>Kriteri 2</b> Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të</p>	<p>Ngarkesa mësimore e personelit akademik realizohet pasi është përcaktuar nga nevoja e departamentit bazuar në legjislacionin në fuqi.  Referuar të dhënave të marra gjatë vizitës në AU, tabela 4/1 në Aneksë, rezulton se ngarkesa minimale</p>

<p>dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>e stafit të brendshëm në këtë program studimi është 31 orë dhe ajo maksimale është 185 orë.  Ngarkesa e stafit të brendshëm në orë mësimore në të gjitha programet që ofron AU rezulton minimalisht 31 orë dhe maksimalisht 536 orë  Ndërsa ngarkesa minimale e stafit të jashtëm në këtë program studimi është 15 orë dhe ajo maksimale është 60 orë.  Ngarkesa e stafit të jashtëm në orë mësimore në të gjitha programet që ofron AU rezulton minimalisht 15 orë dhe maksimalisht 279 orë</p>
---	---

**Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.**

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;  <b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;  <b>Kriteri 3</b> Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Zyra e burimeve njerëzore disponon dhe arkivon në mënyrë korrekte dokumentacion të hollësishëm rreth anëtarëve të personelit akademik të përfshirë në programin e studimit MP në Interier Dizajn dhe të përgjegjësit për organizimin e këtij programi studimi;  Gjatë vizitës së kryer në zyrën e burimeve njerëzore, rezulton se pedagogu Dr në process O. N e parashikuar si pedagog me kohë të pjesëshme, nuk ishte më aktive, ku orët e saj i kalonin pedagogut të aktivizuar me kohë të plotë Msc E. K.  Ky dokumentacion pasqyrohet në mënyrë semestrale.  Mënyrat e rekrutimit janë të mirëpërcaktuara në nivel institucioni, ndërsa procedurat iniciohen dhe ndiqen në nivel njësie bazë në bashkëpunim me zyrën e burimeve njerëzore.</p>
--	---

**Konkluzionet e vlerësimit:**

1. Institucioni përmbush kriteret në lidhje me stafin e angazhuar në programin e studimit MP në Interier Dizajn bazuar në legjislacionin në fuqi në momentin e kërkesës për procesin e vlerësimit.
2. Ndër udhëheqësit aktual janë një PAE dhe një PAK. Përfshirja e profesionistëve të suksesshëm jashtë institucioni si udhëheqës tezash është për tu përgëzuar. Sugjerohet që në raste të udhëheqës nga PAK udhëheqia të kryhet në formën e bashkëudhëheqës, ku bashkëudhëheqësi të jetë PAE. Gjithashtu afrimi i stafit me profil më të përafërt me fushën e kërkimit si ajo e Interier Dizajnit do të ishte më frytëdhënëse.
3. Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Albanian University mbi orët e kryerjes së tezës së diplomës, si dhe nga intervistat e kryera gjatë vizitës, rezulton se Punimi i diplomës zhvillohet vetëm nëpërmjet konsultimeve me pedagogët e zgjedhur, 1 pedagogë PAE- 5 student; dhe 1 pedagogë PAK - 3 student, ndërkohë që punimi i diplomës është i përbërë nga 12 kredite gjatë semestrit të dytë, dhe nuk shfaqet në orarin e programit mësimorë si studio më vete të cilës i duhet dhënë rëndësia e saj për numrin e krediteve që mbart.
4. Duke qënë se është një profesion i ri në tregun e punës aktual, duhet të krijohet një diferencim ndërmjet profilit të arkitektit dhe të dizajnerit të interierit. Për këtë arsye afrimi i stafit me profil në dizajnit e produktit (jo i fokusuar në aspektin grafik të dizajnit), hapësirës së brendshme; materialeve të hapësirës së brendshme dhe jo materialeve të ndërtimit, do të mundësonte krijimin e këtij profili më specifik të këtij profesioni.
5. Duke theksuar rëndësinë për një balancë me të përshtatshme të ngarkesës akademike të pedagogëve të angazhuar në programin e studimit MP në “Interier Dizajn”, sugjerohet që të rishikohet ngarkesa mësimore e pedagogëve dhe të zbatohet 41, datë 24.1.2018, “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”.

#### 4. **Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**

##### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencecat.

Albanian University ofpon një infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e aktiviteteve të nevojshme për të gjitha disiplinat, duke ofruar mjedise të brendshme cilësore duke plotësuar kushtet për studim dhe punë të pavarur të studentëve.

GVJ vizitoi ambientet e Universitetit si klasat, auditorët, laboratorët kompjuterik, sallat e studimit, bibliotekën por dhe hapësirat e tjera të përbashkëta të studentëve. Gjithashtu u konstatua se kishte hapësira për stafin akademik por dhe atë administrativ. Në kuadër të programit Master Profesional "Interier Dizajn" të gjitha veprimtaritë zhvillohen në godinën e Rr. së "Kavajes", përveç orëve Laboratorike që zhvillohen pranë "Alb Cunsult-2" me të cilët është lidhur marrëveshje bashkëpunimi.

##### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit

- Salla për leksione
- Klasa për seminare
- Salla për aktivitete promovuese/ Ekspozita
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale
- Laboratorë për lëndët
- Laboratorë informatike
- Salla interneti
- Salla për bibliotekë
- Mjedis për fotokopjime, librari etj
- Zyra informacioni për studentët
- Nyje hidrosanitare

Mjediset për stafin:

- Mjedise për Përgjegjësin e Departamentit
- Zyra për sekretarinë mësimore
- Zyra për departamentet
- Zyra për personelin akademik

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Planimetria e mundësuar si aneks në RVB, si dhe vizita në institucion nuk lanë nevojën e dokumentacioni shtesë. Të gjithë mjediset e listuar më sipër janë evidentuar gjatë vizitës në institucion

##### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.</b>	

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arrijtjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>I gjithë aktiviteti mësimor i Programit të studimit MP në Interior Dizajn kryhet në një godinë ligjërisht në përdorim të institucionit për një periudhë 10 vjeçare (kontratë e rinovuar rishtazi).</p> <p>Përveç ambjenteve të sallave të leksioneve, seminare, institucioni mundëson punë laboratorike (kompjuterike) në ambjentet e tij ose në ambjentet e subjekteve me të cilët ka marrveshje bashkëpunimi.</p>
--	--

#### Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Në nivel institucioni dhe njësie bazë si departamenti i arkitekturës, institucioni mbështet dhe siguron plotësimin e një sasive modeste të literaturës së nevojshme dhe bashkëkohore.</p> <p>Literatura, libra apo periodike e printuar (hardcopy) specifike e nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit MP në Interior Dizajn, si në projektet kërkimore shkencor dhe për përgatitjen e tezës, është e pamjaftueshme.</p> <p>Ndërsa mundësimi i burimeve të literaturës online në fushën e dizajnit; artit dhe arkitekturës, janë në nivele më të kënaqëshme.</p> <p>Në evidencat bashkëngjitur RVB është evidente hartimi i një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët. Nderkohë që lista e titujve përmban mjaftueshëm literaturë të përgjithëshme të fushës së arkitekturës, ajo nuk përmban mjaftueshëm zëra të lidhur drejtpërdrejt me fushën e interior dizajnit.</p> <p>Oraret aktuale të bibliotekës nuk përputhen me oraret e mësimdhënies në programin MP në Interior Dizajn. Pavarësisht inkurajimit të përdorimit të bibliotekës gjatë orarëve të funksionimit të saj, sugjerohet që biblioteka të përshtasi orarin e disponueshmërisë së saj me programin Master profesional në “Interior Dizajn”.</p>
--	--

#### Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Laboratorët përmbajnë aparatat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me</p>	<p>Institucioni disponon dhe ka vënë në dispozicion të programit të studimit MP në Interior Dizajn, sasi të mjaftueshme; laboratorësh, klasash, zyrash, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimit.</p> <p>Pajisjet dhe aparatat laboratorike janë të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të programit të studimit MP në Interior Dizajn dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara në përputhje me qëllimet e programit.</p> <p>Institucioni mundëson së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike</p>
---	---

<p>qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>kompjuterike, në ambjentet e tija ose në ambjentet e institucioneve me të cilët ka marrëveshje bashkëpunimi (psh. laboratorit Alb-Consult).</p> <p>Nga përfundimet e nxjera nga raporti semestral për Departamentin e Arkitekturës për programin MP “Interier Dizajn” i dorëzuar nga Albanian University, si rrjedhojë e përfundimeve të pyetësorëve nga studentët, rezultojnë se:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kushtet Teknologjike duhen përmirësuar</li> <li>2. Nevojiten më shumë orë Laboratorike (Interier Dizajn dhe Modelim dhe Renderizim)</li> </ol> <p>të dhëna të cilat duhet të merren parasysh nga stafi drejtues i njësisë bazë për përmirësimin dhe vazhdimësinë e këtij programi</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Literatura si libra apo revista periodike e printuar (hardcopy) specifike e nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit MP në Interier Dizajn, si në projektet kërkimore shkencore dhe për përgatitjen e tezës, është e pamjaftueshme. Sugjerohet shtimi i zërave të lidhur drejtëpërdrejtë me fushën e interior dizajn.</li> <li>2. Sugjerohet plotësimi bibliotekës me literaturë të printuar në format libri dhe revistave periodike në fushën e interior dizajn.</li> <li>3. Oraret aktuale të bibliotekës duhet të përputhen me oraret e mësimdhënies në programin MP në Interier Dizajn.</li> <li>4. Pavarisht se institucioni disponon dhe ka vënë në dispozicion të programit të studimit MP në Interier Dizajn, sasi të mjaftueshme; laboratorësh, klasash, zyrash, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimit, për të rritur cilësinë e këtij programi, institucioni duhet të investoj në ndërtimin e një laboratorit të brendshëm për kryerjen e praktikave studimore.</li> <li>5. Nga përfundimet e nxjera nga raporti semestral për Departamentin e Arkitekturës për programin MP “Interier Dizajn” i dorëzuar nga Albanian University, si rrjedhojë e përfundimeve të pyetësorëve nga studentët, rezultojnë se: <ul style="list-style-type: none"> <li>○ Kushtet Teknologjike duhen përmirësuar</li> <li>○ Nevoja për më shumë orë Laboratorike (Interier Dizajn dhe Modelim dhe Renderizim)</li> </ul> </li> </ol> <p>Për sa më sipër duhet të merren parasysh nga stafi drejtues i njësisë bazë për përmirësimin dhe vazhdimësinë e këtij programi.</p>	

## 5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Burimi financiar në programin e studimit Master Profesional në “Interier Dizajn” është tarifa e shkollimit. Referuar RVB rreth 1/3 e këtij burimi shpenzohet për qera objekti, dhe shpenzime të tjera të lidhura me mirëmbajtjen dhe mirëfunksionimin e procesit mësimor. Pjesa tjetër shpërndahet për pagat dhe sigurimet e punonjësve, si dhe shpenzime në lidhje me promovimin, aparaturo, internet, etj.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

- Grantet për kërkim (0%)

- Konsulencat, shërbimet (0%)
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit (100%)
- Sponsorizimet (0%)
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm) (0%)
- Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj (0%)
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj) (0%)

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Referuar RVB, kostoja vjetore e një studenti në programin Master Profesional në “Interior Dizajn”, është 124000 lekë për vit akademik. Ndërsa detyrimi vjetor i cdo studenti bazuar në kontratën tip [evidenca E.3.] është 1500 Euro për vit akademik.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>RVB-ja i referohet vazhdimisht Raportit të Auditit duke specifikuar përmbushjen e të gjithë standarteve të financimit dhe menaxhimit të burimeve financiare nga ana e IAL.</p> <p>Evidencat e mundësuar pas vizitës në institucion në përgjithësi vërtetojnë një situatë financiare të qëndrueshme të institucionit për realizimin e studimeve të ciklit të dytë.</p>
<b>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Bazuar në evidence e mundësuar pas vizitës në institucion, AU harton raporte periodike financiare në rang universiteti.</p> <p>Këto raporte të detajuara dhe eksperiencia shumë-vjecare në treg, dëshmon për një qëndrueshmëri financiare që institucioni ka.</p>
<b>Konkluzionet e vlerësimit:</b>	
<p>1. Në pamje të parë, fakti që një program studimi, të ardhurat e të cilit bazohen gati 100% në tarifën e shkollimit, dhe që numri i stafit akademik është më shumë se numri i studentëve të regjistruar, duket sikur reflekton një deficiencë financiare. Por, duke patur parasysh që stafi i angazhuar në programin e studimit Master Profesional në “Interior Dizajn” është njëkohësisht i angazhuar në programe të tjera të Fakultetit të Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike, atëherë një eficiencë financiare e mjaftueshme është e mundur.</p> <p>2. Raportet dhe pasqyrat financiare të mundësuar pas vizitës në AU, dëshmojnë për një qëndrueshmëri financiare të institucionit për të mundësuar programin Master Profesional në “Interior Dizajn”.</p>	

## 6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Sistemi i Brendshëm i Cilësisë në Albanian University që nga viti 2016 ka ngritur Komisionin e Përhershëm për Vlerësimin Institucional i cili ka për bazë të hartoj politikat e sigurimit të cilësisë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe Standartet Shtetërore të Cilësisë. Kjo njësi në bashkëpunim me Komisionin për Vlerësimin Institucional, harton politikat e vetëvlerësimit dhe përcakton kriteret e vlerësimit të cilat ndiqen për modelet e raporteve vlerësuese.

Cilësuar dhe gjatë vizitës në insitucion nga grupi përfaqësues i NJSBC në fillim të cdo viti akademik, gjatë procesit të mësimdhënies dhe në përfundim të tij analizohen dhe vlerësohen programet mësimore, literatura dhe format e vlerësimit. Kontrolli dhe vlerësimet zhvillohen në bazë të të dhënave statistikore gjatë anketimeve të studentëve, fokus-grupeve, dhe vetëvlerësimet e pedagogëve, si dhe bazuar në raporte semestrale dhe vjetore të njëjësive bazë.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

Sipas RVB, Njësia e Sigurimit të Cilësisë përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, të cilët i kanë të përcaktuara detyrat e tyre (Shiko Aneksë, tabela Nr 9). Sipas dokumentacionit të marrë nga NJSBC për programin MP "Interier Dizajn", anketimet zhvillohen 2 herë në vit me studentët në përfundim të cdo semestri dhe përpara sezonit të provimeve.

Gjatë vitit akademik 2018-2019, në semestrin e pare, në programin MP "Interier Dizajn" janë anketuar rreth 76% e studentëve.

### Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Kontrolli i brendshëm i cilësisë realizohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në bashkëpunim me grupet e sigurimit të cilësisë në nivel departamenti, si dhe nga Komisioni për Vlerësimin Institucional. Kjo realizohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit akademik.

### Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë, NJSBC bashkëpunon me njësitë bazë nëpërmjet grupeve të Sigurimit të Cilësisë të ngritura në nivel departamenti; grupe të cilat përbëhen nga staf akademik i brendshëm i njësisë bazë; 2-3 pedagogë me tituj dhe grada, të cilët rishikojnë kurrikulat dhe syllabuset e lëndëve në bashkëpunim me lektorët e lëndëve.

### Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Vetëvlerësimet kryehen në çdo fund semestri për çdo vit akademik, ku njësia bazë harton dhe dorëzon raport semestral me të dhënat përshkruese dhe sasiore mbi çështje në lidhje me gjëndjen e programeve të studimit, vlefshmërinë e akreditimit; stafin akademik të rekrutuar, rezultatet e studentëve; kalueshmëria dhe nota mesatare, veprimtaritë kërkimore.

### Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike



Në përfundim të çdo viti akademik, NJSBC harton raportin vjetor, ku liston dhe një analizë SËOT të detajuar për çdo departament dhe program studimi pjesë e departamentit të arkitekturës.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;</li> <li>Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;</li> <li>Pyetje konceptuale;</li> <li>Intervista;</li> <li>Etj.</li> </ol> <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);</li> <li>Dëgjime në auditor;</li> <li>Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;</li> <li>Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</li> <li>Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatat, projektet, provimet, etj.);</li> <li>Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</li> <li>Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</li> <li>Etj.</li> </ol>	<p>GVJ gjatë shqyrtimit të RVB por edhe mbështetur në vizitat në AU me Drejtuesen e NJSBC të këtij Institucioni konstaton se: Albania University si pjesë të strategjisë së tij, ka përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe mësim-nxënies dhe, për këtë arsye, mbi baza vjetore bëhet vlerësimi i ecurisë së programeve, nëpërmjet shqyrtimit të anketimeve prej studentëve, mbarëvajtjes së procesit të mësimdhënies, cilësisë së literaturës së përdorur, teknikave pedagogjike të përdoruara nga pedagogët në këtë program studimi etj.</p> <p>GVJ ju komunikua se NJBSC organizon monitorim të vazhdueshëm për procesin akademik i cili kontrollohet gjatë vitit dhe rezultatet e tyre i raporton pranë Rektoratit dhe njësisive bazë përkatëse, duke hartuar raporte me të dhëna për çdo staf të përfshirë në çdo njësi bazë.</p> <p>GVJ konsultoi sondazhet, pjesëmarrjen në mbrojtjen e tezave, ndjekjen e ecurisë së studenteve, punësimin, opinionin e studenteve, rezultatet e marra nga studimi i tregut të punës etj.</p> <p>Rezultatet e përfituara nga pyetësorët i bëheshin të ditura stafit, studentëve si dhe administratës.</p> <p>Të dhënat ishin pjesë e Raportit Semestrat që institucioni vuri në dispozicion.</p> <p>Nga GVJ iu kërkua Sekretarisë Mësimore dokumentacioni lidhur me vlerësimin e studentëve, metodat që përdoren për kontrollin e mësimnxënies të cilat iu vunë në dispozicion.</p> <p>GVJ u njoh konkretisht me procesverbalet e rezultateve të studentëve, mënyrën e vlerësimit të pedagogëve për studentët dhe konstatoi që dokumentacioni ishte i plotë dhe konform dispozitave ligjore.</p>
<b>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Të dhënat e rezultateve bëhen pjesë e raporteve të pjesshme dhe atyre vjetore të NJBSC nga njëra anë dhe Raportit Vjetor të Përgjithshëm që përgatitet në fund të çdo viti akademik</p>

**Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.**

**Kriteri 1** Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;

**Kriteri 2** Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Programet vlerësohen pas çdo semestri dhe në fund të çdo viti akademik bëhet një analizë vjetore. Ky proces është nën përgjegjësinë e NJBSC në bashkëpunim me koordinatorin e procesit mësimor. Procesi i vlerësimit mbështetet nga vlerësimi i studentëve, dhe vetëvlerësimi. Si përgjigje, *feedback* ndaj mangësive, problemeve apo sugjerimeve, në raportin e dorëzuar specifikohet se këto të dhëna pasqyrohen dhe në strategjinë e zhvillimit institucional.

**Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.**

**Kriteri 1** Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;

**Kriteri 2** Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;

**Kriteri 3** Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedurë të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;

**Kriteri 4** Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;

**Kriteri 5** Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

**Kriteri 6** Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

Institucioni garanton sigurimin e cilësisë për programet që ofron. Për të realizuar këtë proces ka një metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese.

**Konkluzionet e vlerësimit:**

Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, takimin me anëtarët e NJBSC, stafin akademik si dhe në takimin me studentët u arrit në përfundimin se:

1. NJBSC (Njësia e Brendshme për Sigurimin e Cilësisë) në Albanian University është e mirëpërcaktuar si njësi permanente e mbështetur në anëtarë të brendshëm.
2. GVJ konstaton që NJBSC prodhon dokumentacion të besueshëm dhe efikas për përmirësimin e cilësisë edhe për MP në "Interier Dizajn".
3. Kjo njësi bazon aktivitetin e saj si një njësi me autonomi dhe përgjegjësi maksimale për të kryer aktivitetin e kontrollit, evidentuar problematikat dhe sugjeruar përmirësimet e nevojshme të cilat lidhen drejtpërdrejt me cilësinë.
4. GVJ konkludon që NJBSC është plotësisht e angazhuar të monitorojë dhe raportojë në mënyrë të vazhdueshme rreth cilësisë së brendshme të njësive bazë në çdo fakultet.
5. Institucioni garanton sigurimin e cilësisë për programet që ofron. Për të realizuar këtë proces ka një metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese.
6. GVJ konkludon që NJBSC duhet të raportojë dhe monitorojë gjithashtu dhe në mënyrë të vazhdueshme rreth cilësisë së brendshme të institucionit.
7. Duhet publikuar dhe rregullisht informacioni i paanshëm dhe objektiv, sasior dhe cilësor për vlerësimin e brendshëm.
8. NJBSC duhet të marrë parasysh dhe angazhim dhe afrimin e përfaqësues nga studentët dhe nga ALUMNI të programeve të tyre.

## POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

### 7. Programi i studimit, organizimi i tij

#### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Në lidhje me programin e studimit Master Profesional në “Interier Dizajni”, institucioni ka të mirë përcaktuar misionin dhe objektivat e programit të studimit, në rregulloren e programit të studimit. Gjithashtu në dokumentacionin e paraqitur nga Departamenti përgjegjës, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies) paraqiten dhe plotësojnë kriteret e duhura. Lëndët pjesë e këtij programi disponojnë syllabuset përkatëse ku parashtrohen qartë elementët përbërës të tyre.

Gjatë takimit me drejtuesit e departamentit u diskutua mbi hartimin e kurrikulës mësimore dhe lëndëve përbërëse. Bashkarisht u arrit në konkluzionin se ka hapësira për tu përmirësuar.

Gjithashtu u evidentua metodologjia dhe kriteret e pranimit të studentëve në këtë program. Nga intervistat e kryera me stafin akademik, studentët dhe sekretarinë, u evidentua se 2 studentë në këtë program nga 8 studentë gjithsej, kanë një diplomë të ciklit të parë jo në përpueshmëri me programin e studimit MP “Interier Dizajni”.

GVJ koshient për përcaktimin e kriterëve të pranimit duke patur parasysh edhe përcaktimin ligjor ku studentët të cilët duan të ndjekin një program të ciklit të dytë MP nuk kanë kriterë specifike hyrëse, (sipas LAL 80/2015, Neni 76, pika 1) i sugjeron IAL-së, që për studentët jashtë profilit të Dizajnit, të marri në konsideratë lëndë pre-rekuzitë nga programi i tyre Bachelor në “Dizajni” për të arritur të njëjtin nivel me studentët të mëparshëm të diplomuar në këtë fushë.

#### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi është lincensuar me Urdhër të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr.669, datë 12/10/2018. Këtë program e ndjekin 8 studentë në total dhe qëllimet dhe objektivat e programit të studimit janë artikuluar qartë në rregulloren e programit të studimit. Shiko Anekse, tabela Nr 10

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

Ky program është i organizuar në formën e studimeve me kohëzgjatje normale 1 vit akademike, dhe 60 ECTS në total.

1 vit akademik ka	30 javë mësimore në auditor
1 Semestër ka	15 javë mësimore në auditor
1 ECTS =	25 orë mësimore pune të studentit
1 orë mësimore =	50'

Programi i studimit Master Profesional në “Interier Dizajni”, ofrohet në 1 vit akademik, 2 semestra. Programi përmban 10 lëndë të organizuara në 10 module bazë me një total prej 60 ECTS të cilët përfshijnë praktikën profesionale si edhe temën e diplomës. Studentët përmbushin kërkesat për titullin Master Profesional në “Interier Dizajni” nëse plotësojnë 60 kredite sipas sistemit ECTS. Kreditet janë të llogaritura sipas sistemit ECTS. Një krediti të formimit i korrespondon 25 orë mësimore punë të studentit, përbërë nga orë mësimore për transmetim

dijesh në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratore, etj.) dhe orë mësimore për përgatitje ose punë individuale të tij.

GVJ e gjen në kurrikulën një shpërndarje jo korrekte të orëve mësimore në punimin e diplomës të gjetura në dokumentacionin e dorëzuar (Plani mësimore Tabela -10 RVB dhe Planit Mësimor të Programit paraqitur në evidencën 7.2.a)

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- Leksionet **202 orë** në auditor dhe **303 orë** orë punë e pavarur e studentit
- Seminaret **61 orë** në auditor dhe **139 orë** orë punë e pavarur e studentit
- Ushtrimet **7 orë** në auditor dhe **5.5 orë** orë punë e pavarur e studentit
- Labororet **60 orë** në auditor dhe **5 orë** orë punë e pavarur e studentit
- Praktikën Profesionale **135 orë** në auditor dhe **15 orë** orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar **24 orë** në auditor dhe **276 orë** orë punë e pavarur e studentit
- Detyra/Projekte **13 orë** në auditor dhe **154.5 orë** orë punë e pavarur e studentit
- Praktikë mësimore **90 orë** në auditor dhe **10 orë** orë punë e pavarur e studentit

Referuar shifrave të paraqitura në RVB dhe në evidencën 7.2.a, mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) është bërë në mënyrë korrekte. Të dy materialet mbështesin njëra-tjetrën. Por nga ana e cilësisë së kësaj shpërndarje ka vend për përmirësime për të cilat Institucioni duhet ti ketë parasysht në të ardhmen.

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Plani mësimor nuk ka pësuar ndryshime në krahasim me programin e licensuar. Ky program akoma nuk ka nxjerrë studentët e tij të parë dhe është aktivizuar si program menjherë pas licensimit, në këtë vit akademik, 2018-2019.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Anekse, tabela Nr 13)

Nga të dhënat e paraqitura në planin mësimor në lidhje me stafin e angazhuar në programin e studimit, ai përbëhet nga 6 pedagogë Personel Akademik Efektiv (me kohë të plotë) dhe 3 pedagogë Personel Akademik me Kontratë (staf me kohë të pjesshme), nga të cilët për Personelin Akademik Efektive 2 me titull Prof.Asoc; ,3 me gradën shkencore Doktor, 1 me gradë shkencore MSc. Personeli Akademik me Kontratë përbëhet nga 1 lektorë me titullin Prof.Dr; 1 me gradën shkencore Doktor dhe 1 në proces doktorature.

Nderkohë në vizitën në institucion rezultoi qe një nga anëtarët e PAE ishte shkëputur. Ngarkesa respective e orëve i është kaluar anëtarëve të tjerë PAE.

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre

- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në Dosjen e Vetvlerësimit, por edhe gjatë konsultimeve me aktorët e ndryshëm gjatë vizitës në Institucion, GVJ konstaton se cilësia e syllabuseve ishte e mirë dhe të përditësuara korrektësisht në përputhje me kërkesat e Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 dhe VKM Nr 41, datë 24.01.2018

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p><b>Kriteri 2</b> Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi i ciklit të dytë, Master profesional në Interier Dizajn, i nënshtrohet për herë të parë procesit të vlerësimit të jashtëm. Programi i studimit Bachelor në “Dizajn” i ofruar edhe ky nga Departamenti i Arkitekturës është i akredituar me vendim të Bordit të Akreditimit nr.74, datë 21.09.2017, ndërsa modulet programit, pjesë e vlerësimit Mp, janë të gjitha të vlerësuara në kredite (ECTS), ku çdo vit akademik është i organizuar në 60 kredite.</p>
<b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b>	
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 7</b> Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi Master Profesional në “Interier Dizajn” është në përputhje dhe në zbatim të strategjisë, misionit dhe qëllimit të Albanian University.</p> <p>Ky program studimi është në përputhje të plotë me kriteret e vendosura, pasi ofron njohuri të thelluara praktike analitike dhe profesionale në fushën e dizajnit të interierit. Në hartimin e programit mësimor është marrë parasysh raporti midis formave të ndryshme të veprimtarive formuese. Kështu rreth 50 % e tyre janë në disiplina karakterizuese që lidhen me fushën, si dhe veprimtari formuese plotësuese si praktika apo stazhe, që e gjejnë një ndarje shumë të përshtatshme për aftësimin e studentëve për nevojat e tregut të punës dhe në përputhje me fokusin profesional të këtij programi master.</p>
<b>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</b>	

<p><b>Kriteri 1</b> Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Organizimi i programit të studimit, lëndët e ofruara janë në përputhje me kërkesat e një programi profesional të ciklit të dytë.</p> <p>Nga shqyrtimi i syllabuseve dhe diskutimet me pedagogët dhe studentët rezultoi që studentët vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme duke përdorur disa metoda vlerësimi të cilat përpiqen të përfshijnë të gjithë gamën e njohurive që studenti përvetëson si ese, detyra, teste, dorëzime të ndërmjetme</p>
<b>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikatat e mira të vendeve europiane;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Në RVB e dorëzuar nga Institucioni, specifikohet se programi i studimit MP në "Interior Dizajn", mbështetet në praktikatat disa vjeçare të vendeve Perëndimore, SHBA dhe Kanada, por pa dhënë një argument më të plotë apo shembuj se si lidhet ky program specifik me përvojat jashtë vendit.</p> <p>Pavarsisht faktit se MP bazohet në modelin dhe standartet sipas sistemit të Bolonjës, duhet të zhvillohet dhe argumentohet më qartë elementët konkurrues të këtij programi në Shqipëri.</p>
<b>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Për vetë natyrën profesionale të këtij programi master, fokusi parësor është aftësimi profesional i studentëve i cili realizohet përmes praktikave të shumta lëndore, orëve me natyrë aplikative si studio ose laborator, etj.</p> <p>Programet e studimit të ofruara nga Departamenti i Arkitekturës janë të hartuara në përputhje me strategjinë e zhvillimit të Institucionit.</p> <p>Gjatë vizitës së kryer dhe nga intervistat me personelin akademik, konstatoam se i gjithë personeli akademik i angazhuar në këtë program zhvillon kërkim shkencor sipas profilin të tyre.</p> <p>Sygjerohet që puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve të zhvillohet më shumë me profilin e programit të studimit.</p>
<b>Standardi I.7 - Programet e studimeve "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>Nga vizita në institucion si dhe intervistat me drejtuesin e departamentit, si dhe studimi i tregut i dorëzuar nga Albanian University, duket qartë se është kryer studimi i tregut për programin e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional".</p> <p>Në lidhje me plotësimin e nevojave të tregut të punës për këtë profesion, në raportin e "Studimit të Tregut të Punës" argumentohet se ka mangësi, argument i cili është i drejtë, por gjithmonë ekziston risku i mbivendosjes së profesionistit arkitekt me një dizajner interieri.</p>
<b>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</b>	

<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar;</li> <li>kërkesat e punëdhënësve;</li> <li>një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</li> <li>numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</li> </ol>	<p>Program i studimit Master Profesional në “Interier Dizajn” është mbështetur mbi planin strategjik të IAL.</p> <p>Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe diskutimeve të hapura në Albanian University, si dhe nga informacionet e dhëna për punësimet në tregun e punës u vu re se ky program është përshtatur me nevojat e tregut të punës si dhe studentët që kanë ndjekur studimet në këtë program janë të punësuar në tregun e punës.</p>
<p><b>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programet e studimit të ofruara janë në përputhje me nevojat dhe interesat kombëtare në fushën e interiorit.</p>
<p><b>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	<p>N/A</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>GVJ konstaton që MP në “Interier Dizajn” në Albanian University realizohet me 60 ECTS me kohëzgjatje 1 vit akademike, kjo në përputhje me aktet ligjore për hapjen e tij.</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	<p>N/A</p>
<p><b>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Programi i studimit, me lëndët përbërëse të tij, sipas viteve dhe semestrave vihet në dispozicion cdo fillim semestri nga pedagogët e lëndeve, hardcopy apo elektronike.</p>
<p><b>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Procedura e diplomimit është e shpjeguar në rregulloren mësimore, ku përgjegjësi i Departamentit u bën të njohur procedurën e diplomës.</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <p>Bazuar në dokumentacionin e konsultuar dhe takimet me drejtuesit, stafin dhe studentët gjatë vizitës në Institucion, GVJ gjykon se:</p>	

1. Programi i Studimit MP në "Interior Dizajn" është hartuar në përputhje me misionin, vizionin dhe strategjinë për zhvillim të institucionit.
2. Plani mësimor i tij është i organizuar në module dhe çdo modul është i vlerësuar me ECTS.
3. Programi MP në "Interior Dizajni" zhvillohet në 1 vit akademik.
4. Programi adreson nevojat e tregut të punës, të cilat janë identifikuar nga IAL nëpërmjet një studimi të tregut.
5. Objektivat e programit dhe përmbajtja e kurrikulës janë të përshtatshme për nivelin e studimit dhe mundësojnë aftësimin profesional dhe shkencor të studentëve.
6. Rekomandohet implementimi i sistemit elektronik për të aksesuar syllabuset e lëndëve, të cilat përfshijnë: temat e lëndës, literaturën kryesore, format e kontrollit të dijeve, literaturën e rekomanduar, rekomandim që ngelet për tu riparë në të ardhmen.

## 8. Mësimdhënia

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Plani mësimor në Albanian University, shpjegohet në Rregulloren mësimore të programit. Plani mësimor është i organizuar në bazë grupi; kursi dhe nënkursi, ku leksionet zhvillohen në bazë grupi; ushtrimet dhe seminarët në bazë grupi mësimor dhe punët laboratorike janë të zhvilluara në bazë nëngrupi mësimor.

Sipas rregullores mësimore të programit, frekuenca e leksioneve, seminareve, ushtrimeve, orët laboratorike, praktikat mësimore dhe detyrat apo projektet, kanë një detyrim frekuentimi prej 75%. Frekuentimi praktikës profesionale është i detyrueshëm. Lëndët gjithashtu organizohen në lëndë të detyrueshme dhe lëndë me zgjedhje. Metoda e mësimdhënies kanë një përbërje teorike - praktike. Gjithashtu procesi mësimor është gjithmonë në vlerësim periodik nga mekanizmat e NJSBC.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

Bazuar në tabelën 10 konstatohet që peshën më të madhe të orëve e zënë leksionet krahasimisht me praktikën profesionale dhe Praktikën Mësimore, evidencë e cila në lidhje me natyrën e programit si dhe komentet e studentëve në disa lëndë si "Interior Dizajn 1" dhe "Modelim dhe Renderizim" (Raporti Semestral), kërkohet më shumë orë laboratorike apo praktike. Gjithashtu, nuk ishte e evidentuar në orarin zyrtar lënda "Punim Diplome", ku nuk figuron se zhvillohet si lëndë gjatë javës.

Në lëndët formuese profesionale të programit MP në "Interior Dizajn" siç janë Interior Dizajn 1, Interior Dizajn 2 sugjerohet që shpërndarja e krediteve dhe orëve të jetë në mënyrë më të balancuar rreth orëve praktike dhe laboratorike kundrejt orëve teorike dhe leksioneve duke marrë në konsideratë natyrën praktike dhe sa më afër qasjes profesionale të një programi studimi Mp në "Interior Dizajn".

Format e kontrollit të njohurive

Sa i takon vlerësimin, GVJ gjen formate të ndryshme të kontrollit të dijës si: detyra kursi, projekte, punë laboratorike, teste, etj, që bën të mundur vlerësimin në të gjithë formimin e studentit dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve për çdo lëndë / modul.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj



Ndonëse program i ri por dhe intensiv për studentët, krahasimisht me ata që vazhdojnë studimet me kohë të plotë, studentët në këtë program janë përfshirë në aktivitete të ndryshme të departamentit si ekspozita; prezantime; etj. Do të ishtë mirë përfshirja e tyre në konferenca, projekte kërkimore, mobilitet me institucione partnere, etj në fushën e dizajnit të interierit.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- (i) Rregullore e programit të studimit
- (ii) Plani mësimor
- (iii) Syllabuset
- (iv) Procesverbale të vlerësimit për lëndë / module të përzgjedhura rastësisht

## 9. Studentët

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Programi i studimit Master Profesional në “Interier Dizajn” ka në fokus studente të cilët kanë përfunduar studimet e ciklit të parë, dhe kërkojnë të thellojnë njohuritë e tyre në sektorin e dizajnit të interierit. Sipas intervistave të kryera në institucion, si dhe materialeve të dorëzuara nga Albanian University për programin MP “Interier Dizajn” figuron se janë të regjistruar 8 studentë në total, ky 5 prej tyre janë ALUMNI të Albanian University të programi Bachelor në “Dizajn” dhe 3 studentë të ardhur nga programe të tjera, 1 profil Bachelor “Art dhe Dizajn”; 1 Profil “Turizëm” dhe 1 profil “Ekonomik”.

### Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Në këtë program studimi pranohen student të cilët kanë:

1. kanë përfunduar dhe janë të pajusur me diplomë të ciklit të parë të studimeve;
2. zotërojnë dokumentacion ligjor të nivelit të parë të studimeve
3. nuk rezultojnë të regjistruar në një program tjetër në IAL- publik apo privat

Gjatë vizitës së GVJ në institucion dhe gjatë intervistave me stafin drejtues u konstatua se 1 student e regjistruar më parë në programin MP “Interier Dizajn” ishte njëkohësisht aktive dhe në një program tjetër, duke rezultuar në pezullimin e saj nga MP “Interier Dizajn”.

Në lidhje me kushtet specifike të pranimit të studentëve në MP “Interier Dizajn”, përtej Kritereve dhe Procedurave të Pranimit të Studenteve, çdo kandidat i cili do të bëhet pjesë e këtij programi i kërkohet nga institucioni të plotesojë:

- Formularë Aplikimi
- Kopje e Noterizuar e diplomës së Shkollës së Lartë, të lëshuar në përfundim të programit të studimit të ciklit të parë
- Lista e notave kopje e noterizuar
- CV e kandidatit
- Dokument Identifikimi
- 2 Fotografri
- Shtetas të huaj duhet të paraqesin leje qëndrimi në Shqipëri

- Shtetas të huaj duhet të paraqesin dhe vërtetim të njohjes së gjuhës shqipe
- Letër interesi ku paraqesin interesat kerkimore dhe profesionale për kryerjen e programit të Studimit Master Profesional në “Interier Dizajn”

Përveç kritereve të pranimit si mësipër për student në këtë program si dhe dokumentacionit të dorëzuar nga ta, rezulton se nuk ka kritere pranimi specifik të pranimit të studentëve (për student në fusha jo të ngjashme më atë të Interierit, Arteve apo Dizajnit), kritere të cilat duhen marrë në konsideratë për mos krijimin e niveleve të ndryshme të studentëve të cilët i përkasin fushave të ndryshme të studimeve të mëparshme

Duke marrë parasysh specifikën e këtij programi; njësitë bazë të programit MP duhet të kenë kusht specifika të posaçme për pranimin e studentëve. Kjo për arsye se jo çdo kush me profil jashtë kësaj fushe mund të ndjekë këtë program studimi.

Gjatë vizitës së GVJ në institucion dhe gjatë intervistave me stafin drejtues; së RVB, dhe studentët u konstatua se dy nga studentët aktiv në këtë program nuk ishin të profilit (këta student ishin të profilit turizëm dhe të profilit ekonomik) të mëparshëm në dizajn si ata student nga programi Bachelor në “Dizajn” të Albania University. Kjo krijon një disbalanc në mësimdhënie për studentë të fushave të ndryshme.

Për këto arsye, sugjerohet të jepen lëndë plotësuese për studentë jashtë profilit të dizajnit të interierit, si dhe duhet të specifikohen kritere pranimi. Ndër kriteret e pranimit sugjerohet të jetë dhe portfolio e punimeve të mëparshme të studentit të cilat vërtetojnë aftësinë e tij për të ndjekur studimet master në programin e ri.

**Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve**

Ky program studimi nuk ka nxjerrë asnjë student deri në momentin e vlerësimit. Studentët e parë diplomohen gjatë muajit Korrik 2019

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare (Anekse, Tabela Nr 17)

Numri i studentëve të regjistruar për herë të parë në vitin akademik 2018-2019 ka qënë 10 studentë me mesatare 8.16. Gjatë vitit akademik, 2 studentë janë cregjistruar dhe numri aktual ka kaluar në 8 studentë.

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

Programi i studimit Master Profesional në “Interier Dizajn” nuk ka nxjerrë studentët e parë dhe kjo e bën të pamundur pasqyrimin e statistikave.

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Nuk ka evidence për mobilitet brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Të dhëna për punësimin e studentëve

Programi i studimit Master Profesional në “Interier Dizajn” nuk ka nxjerrë studentët e parë dhe kjo e bën të pamundur pasqyrimin e statistikave të punësimit të studentëve.

Numri total të diplomuarve

Programi i studimit Master Profesional në “Interier Dizajn” nuk ka diplomuar akoma studentët e parë dhe kjo e bën të pamundur pasqyrimin e statistikave të diplomimit.

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Programi i studimit Master Profesional në “Interier Dizajn” nuk ka nxjerrë studentët e parë dhe kjo e bën të pamundur pasqyrimin e statistikave të punësimit të studentëve.

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

Programi i studimit Master Profesional në “Interier Dizajn” nuk ka nxjerrë studentët e parë dhe kjo e bën të pamundur pasqyrimin e statistikave të punësimit të studentëve.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

- Vërtetim ndryshim emri për studentin T. A. (Emri i mëparshëm: E. A.)
- Lista e angazhimeve profesionale e studentëve aktual.

### **Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit Europian të Gjuhëve;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Interier Dizajn” ka në fokus studentë të cilët kanë përfunduar studimet e ciklit të parë, dhe kërkojnë të thellojnë njohuritë e tyre në sektorin e dizajnit të interierit.</p> <p>Studentët e regjistruar plotësojnë kriteret e përcaktuara nga Albania University për regjistrimin e tyre si dhe dokumentacionin e paraqitur për regjistrim.</p> <p>Referuar akteve nënligjore për programet master profesional nuk është detyrim ligjor mbrojtja e gjuhës angleze nga studentët.</p> <p>Në diskutimet me stafin e Albania University u vu re se IAL nuk ka të hartuara plane të mundshme për kriteret e pranimit, kriteret e cilat duhen marrë në konsideratë për mos krijimin e një disbalance në mësimdhënië për student të fushave të ndryshme.</p>
<b>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Sipas dokumentacionit dhe diskutimeve në Albania University u vu re se studentët ishin të informuar dhe merrnin informacion të përgjithshëm mbi strukturën institucionale, ofertën akademike, rezultatet e të nxëniet dhe orientimit në tregun e punës si dhe kushtet për kalimin nga një vit në tjetrin.</p> <p>GVJ konstaton që kriteret e përcaktuara në zbatim të këtij standarti përmbushen edhe përmes ngritjes, funksionimit dhe veprimtarisë së Zyrës së Kordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës.</p> <p>Kjo zyrë ishte e angazhuar me informimin e studentëve përpara dhe gjatë ndjekjes së studimeve, njohjen e tyre me tregun e punës, ndërmjetësimin e lehtësimit të procesit të punësimit, aty ku ishte e mundur.</p>
<b>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Interier Dizajn” nuk ka nxjerrë studentët e parë dhe kjo e bën të pamundur pasqyrimin e statistikave të punësimit të studentëve.</p>

<b>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Gjatë vizitës në Albanian University, GVJ u informua se institucioni disponon, mban dhe përditëson edhe nëpërmjet ZMSKK statistikat e punësimit për studentët që kanë përfunduar studime, por akoma jo për programin e studimit MP “Interier Dizajn”.</p>
<b>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Intitucioni disponon të dhëna mbi numrin e të regjistruarve dhe larguar nga programi i studimit të ciklit të dytë, si dhe të dhëna mbi ecurinë e tyre.</p> <p>Gjatë vizitës u verifikua se këto të dhëna ishin të regjistruara në regjistrin themeltar.</p>
<b>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Për këshillimin e studentëve, AU ofron udhëheqje për ecurinë e procesit akademik dhe përmes shërbimit të tutoratit.</p> <p>Mundësinë për kryerjen e praktikës profesionale, IAL e ofron nëpërmjet institucioneve të cilat Albanian University ka marrëveshje.</p>
<p><b>Konkluzionet e vlerësimit:</b></p> <p>Metodologjia dhe kriteret e pranimit të studentëve në këtë program janë në përputhje me Rregulloren e pranimit të studentëve në këtë program studimi. Për vetë natyrën specifike të këtij programi studimi, GVJ i sugjeron Institucionit, duke mos e penalizuar, por duke reflektuar cilësi në përzgjedhjen e kandidatëve duke rritur gjithashtu dhe nivelin e konkurrencës positive në auditoret akademike.</p> <p>Nga dokumentacioni i shqyrtuar dhe nga bisedat me studentët GVJ konstaton që ata marrin informacion për akreditimin e institucionit dhe programeve të studimit si dhe janë të informuar për vlerën e diplomës si në tregun e brendshëm ashtu edhe atë të jashtëm të punës.</p> <p>Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës në mënyrë që ata të marrin informacione të vazhdueshme mbi tregun e punës</p> <p>Në lidhje me statistikat vjetore të të regjistruarve, diplomuarve, punësuarve, shembujve të suksesit; Programi i studimit Master Profesional në “Interier Dizajn” nuk ka nxjerrë diplomuar akoma brezin e parë dhe kjo e bën të pamundur pasqyrimin e disa nga statistikat e kërkuara</p> <p>Institucioni tregon një angazhim të kënaqshëm për ta aftësuar studentin përmes procesit të mësimdhënies për ta orientuar sa më mirë atë nëpërmjet të tutoratit dhe për ta mbështetur atë në tregun e punës.</p>	

## **KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.**

### **10. Kërkimi shkencor**

#### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Programi i studimit Master Profesional në “Interier Dizajn” referuar objektivave të tij është një program i orientuar drejt tregut të punës. Si rrjedhojë nuk priten punë të mirëfillta shkencore. Por, nga ana tjetër studentët që studiojnë në këtë program inkurajohen të marrin pjesë në aktivitete të organizuar nga njësia bazë apo institucioni (si për shembull ekspozita, leksione të hapura, konferenca studentore, etj). Gjithashtu mundësimi i praktikës mësimorë pranë laboratorëve si “Alb Consult” afron më tepër studentin me aspektin shkencor të materialeve të rëndësishme që përdoren kryesisht në fushën e interier dizajn.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

Të dhëna për kërkimin shkencor

Në kuadër të programit të studimit Master Profesional në “Interier Dizajn” nuk ka evidenca të kërkimit shkencor. Por personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është i angazhuar në fushat e tyre respektive kërkimore duke synuar publikime apo pjesmarrje në konferenca shkencore.

Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL

Është raportuar që stafi akademik efektiv i IAL në rang Fakulteti ka 9 (nëntë) botime gjatë vitit akademik 2017-2018 dhe semestrit të parë të vitit akademik 2018-2019.

Numri i projekteve kërkimore të fituara.

Në programin e studimit Master Profesional në “Interier Dizajn” nuk ka projekte kërkimore të fituara.

Numri i projekteve të zbatuara

Në programin e studimit Master Profesional në “Interier Dizajn” nuk ka projekte të zbatuara.

Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL

Në programin e studimit Master Profesional në “Interier Dizajn”, si pjesë e aktiviteteve shkencore mund të përmenden praktikat mësimore pranë laboratorit “Alb-Consult”

Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL

Janë raportuar 14 pjesëmarrës në aktivitete shkencore brenda IAL gjatë vitit akademik 2017-2018 dhe semestrit të parë të vitit akademik 2018-2019.

Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor

Në programin e studimit Master Profesional në “Interier Dizajn”, një pjesë e praktikës mësimore kryhet në laboratorë si “Alb-consult” ku synohet trajtimi shkencor i temës së materialeve të ndërtimit. Përveç kësaj, në fund të vitit akademik priten të përftohen 8 punime diplome.

Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor

Në programin e studimit Master Profesional në “Interier Dizajn” aktualisht studiojnë 8 studentë të cilët angazhohen në aktivitetet shkencore të lart përmenduar.

Numri i Çmimeve Kombëtare

Në programin e studimit Master Profesional në “Interier Dizajn” nuk ka Çmimeve Kombëtarë të fituar.



**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>GVJ ju komunikua se Personeli akademik është aktiv në pjesëmarrje në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Ndërsa publikimet në revista shkencore janë në nivel modest.</p> <p>Kjo lidhur dhe me faktin që fusha e arkitekturës dhe në veçanti ajo e Interier dizajnit është më shumë e fokusuar në projektim.</p> <p>Sugjerohet që personeli akademik të mbështetet financiarisht në pjesëmarrje në aktivitete shkencore.</p>
<b>Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional “Interier dizajn” është 100% në gjuhën Shqipe.</p>
<b>Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>Në gjykimin për këto kritere, GVJ është mbështetur në Evidenca 10.3 “Trajnimi për personel akademik”, në të cilën pasqyrohen organizimi i aktiviteteve trajnuese specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor/ shkencor.</p> <p>Por numri i tyre është modest (vetem 2 për vitin akademik 2018-2019). Sugjerohet shtimi i numrit të aktiviteteve të ngjashme.</p>
<b>Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>Institucioni mbledh dhe arkivon formularët e vlerësimit cdo fund viti akademik duke vlerësuar aktivitetet akademike shkencore që stafi akademik ka ndërmarrë gjatë vitit. Këto të dhëna ruhen në department si dhe në zyrën e Koordinimit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve Akademike. [Evidenca 10.2]</p>
<p><b><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Personeli akademik është aktiv në pjesëmarrje në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare. Ndërsa publikime në revista shkencore është në nivel modest. Kjo lidhur dhe me faktin që fusha e arkitekturës dhe në veçanti ajo e Interier dizajnit është më shumë e fokusuar në projektim.</li> <li>Stafi akademik është gjithashtu i angazhuar në aktivitete trajnuese.</li> </ol>	

3. Sugjerohet që personeli akademik të mbështetet financiarisht në pjesëmarrje në aktivitete shkencore.
4. Sugjerohet shtimi i numrit të programeve trajnuese specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor/ shkencor.

## 11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Nga shikimi me kujdes i Dosjes se Vetvlerësimit, GVJ konstaton se Departamenti i Arkitekturës ka marrëvshje bashkëpunimi dypalëshe me një mori subjektsh dhe institucione. Bashkëpunimi me mbi 20 subjekte private nxit mbarëvajtjen dhe suksesin në kuadër të praktikave profesionale. Me këto subjektet janë bërë kontrata disavjecare dhe me disa prej tyre të përherëshme. Përveç sektorit privat, departamenti bashkëpunon me institucione qeveritare dhe 6 universitete vendase. Bashkëpunimet me IAL janë një mundësi e mirë për të shërbyer për shkëmbimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, dhe organizimi i aktiviteteve të përbashkëta.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

▪ Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare	2
▪ Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj	2
▪ Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit	1
▪ Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL	0
▪ Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor	5 <sup>1</sup>
▪ Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime	31

<sup>1</sup>Lista e laboratorëve

Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë:

- Institucionet qeveritare bashkëpunuese
- Organizatat Profesionale
- Komuniteti i biznesit, tregu i punës

Marëveshjet aktuale janë të mjaftueshme nga ana sasiore, për të mbështetur programin Master Profesional “Interier Dizajn”. Disa prej tyre shërbejnë në mënyrë të drejtpërdrejtë për përmirësimin e praktikës profesionale e cila është pjesa kyçe për një program studimi MP. Marëveshje të tjera të karakterik logjistik (lehtësime në printime, në material bazë të profesionit, etj) lehtësojnë procese kyçe të procesit të mësimdhënies/ mësimnxënies në programin Master Profesional “Interier Dizajn”.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitim të njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>Institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me 22 ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese, për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve Master Profesional në “Interior dizajn”.</p>
<b>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Një frymë bashkëpunimi dhe mirëkuptimi midis stafit akademik të angazhuar në programin Master Profesional në “Interior dizajn” u vu re gjatë vizitës dhe takimit me stafin akademik.</p>
<b>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkëpunim me punëdhënësit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Përveç sektorit privat, departamenti bashkëpunon me 6 institucione qeveritare dhe 6 universitete vendas. Bashkëpunimet me IAL shërbejnë për shkëmbimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, organizimi i aktiviteteve të përbashkëta si ekspozita, konferenca, ëorkshope, trajnime, etj.</p> <p>Si pjesë e marrëveshjeve të bashkëpunimit janë dhe aktivitetet që lidhen me praktikën profesionale e cila mbikëqyret nga punëdhënësi në bashkëpunim me perfaqësues nga stafi akademik.</p>
<b>Konkluzionet e vlerësimit:</b>	
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me 22 ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese, për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve Master Profesional në “Interior dizajn”</li> <li>2. Përveç sektorit privat, departamenti bashkëpunon me 6 institucione qeveritare dhe 6 universitete vendas. Bashkëpunimet me IAL shërbejnë për shkëmbimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, organizimi i aktiviteteve të përbashkëta si ekspozita, konferenca, ëorkshope, trajnime, etj.</li> <li>3. Sugjerohet arritja e marrëveshjeve të bashkëpunimit edhe me institucione apo programe të ngjashme të huaja, kryesisht në rajon. Mundësitë e programit të bashkëpunimit Erasmus+ duhen konsideruar maksimalisht në këtë drejtim.</li> <li>4. Ndërkohë që marrëveshjet me sektorin privat brenda vendit janë në nivele të mjaftueshme, sugjerohet shtimi i bashkëpunimeve mes IAL jashtë vendit.</li> </ol>	



## ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR IMPLEMENTIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

### **I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS -PIKAT E FORTA, WEAKNESSES - PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES -MUNDËSITË, THREATS - PENGESAT)**

#### **Pika të forta:**

1. Programi i studimit është hartuar në përputhje me strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe adreson nevojat e tregut të punës. Programi është i hartuar në përputhje me nivelin e studimit dhe ka objektiva formimi të mirëartikuluar.
2. Marrëveshjet e bashkëpunimit të Albanian Univeristy me shumë kompani dhe biznese të ndryshme e konsolidojnë më shumë këtë program.
3. Mungesa e programeve të ngjashme në vendin tonë.

#### **Pika të dobëta:**

1. Shumica e pedagogëve të angazhuar janë me profil arkitektonik të përgjithshëm dhe inxhinierik. Për këtë arsye, sugjerohet afrimi i profesionistëve në fushën e Dizajnit apo kualifikimi me trainime shtesë të lidhura me fushën e dizajnit të interiorit për stafin ekzistues.
2. Mungesa e laboratoreve të modelimit (p.sh për makete/projekte studentore, etj) brenda Universitetit për studentët të cilët ndjekin këtë program studimi. Sugjerohet implementimi i laboratorëve që mundësojnë sa më mirë lidhjen e teorisë me praktikën brenda ambjenteve të Albanian University.
3. Literatura e lidhur drejtpërdrejt me fushën e interior dizajn është e pamjaftueshme.

#### **Mundësitë:**

1. Mundësitë e formimit të një biblioteke të literaturës me fokus dizajnin dhe interiorin që mund të kthehet si një pikë referimi ndër bibliotekat universitare.
2. Mobilitetet për programin ERASMUS + me Universitete të tjera, për të qënë pjesë e projekteve të financuara nga BE që mundësojnë mobilitetin e stafit dhe të studentëve, pritet të kontribuojnë për rritjen e atraktivitetit të programit duke rezultuar në rritje të sasisë dhe cilësisë së të regjistruarve.

#### **Pengesat:**

1. Tregu i punës në lidhje me interior dizajni është i pamatshëm, për arsye se shume specialist të fushave të përafërta e ushtrojnë dizajnin e interiorit si profesion aktualisht.
2. Mungesa e një sistemi elektronik për të aksesuar silabuset, programin e studimit; vlerësimet e pedagogut; frekuentimi; si dhe cdo dokument zyrtar në lidhje me programin e studimit.etj.
3. Largimi i studentëve jashtë vendit, për kushte më të mira ekonomike dhe arsimore.
4. Mungesa e stafit të profilizuar në fushën e interior dizajn në vend.

#### **Rekomandime:**

1. Shtimi i literaturës me fokus dizajnin dhe interiorin
2. Sugjerohet implementimi i laboratorëve që mundësojnë sa më mirë lidhjen e teorisë me praktikën brenda ambjenteve të Albanian University
3. Sygjerohet që në programin MP "Interior Dizajn" të integrohen më shumë lëndë me zgjedhje me fokus në interior. Kjo mund shtonte kerkesat per rregjistrime në këtë program.
4. Mundësimi i orarit të posaçëm për disa nga shërbimet e ofruara në Universitet në lidhje me programin MP "Interior Dizajn" do te shtonte produktivitetin dhe suksesin e programit (si sherbimi i biblotekës).
5. Sugjerohet implementimi i një sistemi elektronik për të aksesuar silabuset, programin e studimit; vlerësimet e pedagogut; frekuentimi; si dhe çdo dokument zyrtar në lidhje me programin e studimit, etj.



## II. SUMMARY ANALYSIS BY EEG ACCORDING TO SWOT METHOD (STRENGTHS, WEAKNESSES, OPPORTUNITIES, THREATS)

### Strengths:

1. The study program is designed in accordance with the institution's development strategy and addresses the needs of the labor market. The program is designed in accordance with the level of study and has well-articulated training objectives.
2. Albanian University has cooperation agreements with many companies and businesses which consolidate this program more.
3. Lack of similar programs in Albania.

### Weaknesses:

1. Most of the engaged lecturers are of general profile of either architectural or engineering. Thus, it is suggested that the university either recruits professionals in the field of interior design or offer qualification with additional training related to the interior design field for the existing staff.
2. The lack of prototyping and modeling laboratories inside the University structure (student models, projects) for students involved in this program. It is suggested the implementation of laboratories that best enable the connection of the theory with practice within the premises of Albanian University.
3. Literature directly related to the field of interior design is inadequate.

### Opportunities:

1. Possibilities of creating one of the first library with specific focus on design and interior, which could be turned into a reference point among university libraries.
2. Mobilities within ERASMUS + framework with other Universities, are seen as a great opportunity to be part of EU-funded projects that enable staff and student mobility. These are expected to contribute in increasing the program attractiveness resulting in quantity and quality of the enrolled students.

### Threats:

1. The labor market related to interior design is immeasurable, due to the great number of specialists related in this field presently active in the market.
2. Lack of an electronic system to access syllabus, study program; pedagogical assessments; frequency; as well as any official document related to the study program.
3. Students going abroad for better economic and educational conditions.
4. Lack of specialized staff in the field of interior design.

### Recommendations:

1. Addition literature focused in design and interior
2. It is suggested that Albanian University implements laboratories that best enable the connection of the theory with practice.
3. It is suggested that in the Professional Master "Interior Design", more subjects with focus interior should be implemented.
4. Additional hours for some of the services that Albania University offers, for the Professional Master in "Interior Design", would increase the productivity and success of the program (such as the library service).
5. It is suggested to implement an electronic system to access syllabus, the study program; pedagogical assessments; frequency; as well as any official documents related to the study program.

### Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

1. Dr. Sonia Jojic
2. Dr. Artan Hysa